



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Nëntor 2022

11

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



NIS ZBATIMIN I PARI PROGRAM KODIMI NË SHQIPËRI PËR FËMIJËT QË NË KLASË TË PARË

Në kuadër të **Programit të Ekipeve Sportive**, përgjatë muajit nëntor, u shpërndanë **uniformat dhe baza materiale për vajzat dhe djemtë e ekipeve sportive**, në mbi **14 qytete e qarqe të vendit**, që mbulohen tërësisht nga **fondi i Qeverisë Shqiptare**. Konkretisht në gjithë **Qarkun Elbasan, Fier, Lezhë, Malësi e Madhe dhe Durrës**, ndërsa pjesërisht është bërë shpërndarja në **Qarkun Vlorë dhe Tiranë**.

Së bashku me kryeministrin, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka zhvilluar vizita në disa qytete të Shqipërisë: Lushnje, Roskovec, Korçë, Vlorë, Tropojë, Dibër, Burrel, Bulqizë, Kolonjë dhe Kamëz, për të parë nga afër zbatimin e programit dhe për të takuar fëmijët dhe të rinjtë sportdashës të këtyre ekipeve të volejbollit dhe basketbollit.

Tashmë, në Qarkun e Vlorës janë ngritur **42 ekipe sportive**, në volejbol dhe basketbol, duke përfshirë **581 nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme**. Ndërsa, **37 ekipe sportive për basketbol dhe volejbol**, në shkollat 9-vjeçare dhe gjimnaze, janë ngritur në Qarkun e Elbasanit, duke përfshirë 924 nxënës, si dhe **42 ekipe sportive** janë ngritur në Qarkun Lezhë duke përfshirë 581 nxënës.

Kurse në Qarkun e Durrësit po zhvillojnë stërvitjen për kampionatet që do të zhvillohen në nivel lokal por edhe qendror, **42 ekipe sportive**, duke përfshirë 581 nxënës, e në Qarkun e Fierit janë ngritur **33 ekipe sportive** me përfshirjen e 939 nxënësve.

Në Kamëz janë ngritur **18 ekipeve sportive në volejbol dhe basketbol**, të cilët tashmë kanë filluar stërvitjen dhe së shpejti **do të garojnë në kampionatet sportive**, të cilat do të zhvillohen në kuadër të **Programit të Ekipeve Sportive**. Dhe në Qarkun e Tiranës janë ngritur **83 ekipe** me përfshirjen e **1196 nxënësve**.

Ky program iu ofron të rinjve mundësinë që, në orët mbas mësimi, **të përfshihen në aktivitete sportive si volejbol dhe basketbol**, duke u larguar kështu nga zakonet jo të mira që sjellin pasivitet dhe **promovuar mirëushqyerjen për mirëmbajtjen e shëndetit**.



ZHVILLOHEN DISA TAKIME ME TË RINJTË NË VAZHDËN E TAKIMEVE NË QYTETE TË NDRYSHME TË SHQIPËRIE

Për të promovuar **potencialin rinor** të anëtarëve të **Këshillit Vendor Rinor**, dhe jo vetëm, përgjatë këtij muaji, u zhvilluan takime të ndryshme me të rinjtë e **Lushnjës, Roskovecit, Korçës, Vlorës, Beratit, Tropojës Dibrës, Burrelit, Bulqizës, Kolonjës dhe Kamzës**, së bashku me kryeministrin dhe kryebashkiakët, me qëllim zhvillimin e bashkëbisedimeve me të rinjtë.

U diskutua konkretisht rreth **teknologjisë, arteve, zejeve, sportit dhe angazhimit** që të rinjtë kanë ndërmarrë për të kontribuar drejtpërdrejtë në **përmirësimin e qytetit** ku jetojnë, duke përgatitur dhe projekte konkrete.

Vizita në Qytezën e Fëmijëve në Korçë, një qendër multifunktionale për fëmijët dhe të rinjtë, kishte në fokus **Programin Jashtë Orarit Mësimor**, i cili do t'u japë mundësinë fëmijëve dhe të rinjve të kalojnë **kohë produktive gjatë kohës së lirë pas shkolle**, në fusha të ndryshme si teknologji, arte, zëjt, sport dhe kopshte të gjelbra. Kurse në takimin me të rinjtë e KVR-ve të Beratit u theksua **përfshirja e tyre në proceset politikëbërëse lokale dhe qendrore**.

Gjithashtu, edhe në Kamzë u mbajt një **bashkëbisedim i hapur me të rinjtë**, për të dëgjuar çdo ide dhe koment që ata kanë, për të rritur cilësinë e jetesës në komunitetin ku jetojnë dhe përfaqësuar zërin e të rinjve në **Këshillin Vendor Rinor**. Njëjtë siç u përfshinë në konsultimin për hartimin e **Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029**.



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Nëntor 2022

11

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



MBAHET MBLEDHJA SOLEMNE MES KUVENDIT TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS, NË KUADËR TË 110-VJETORIT TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Me rastin e **110-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë**, më 27 nëntor, u mbajt mbledhja e parë e përbashkët mes Kuvendit të Shqipërisë dhe Kosovës, në sallën e seancave plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Mbledhja u hap nga **kryetarët e Kuvendeve** përkatëse, duke u pasuar me fjalën përshëndetëse të **kryeministrit të Shqipërisë dhe Kosovës**. Gjithashtu, seanca u parapri me një **koncert mirëseardhjeje** nga Teatri i Operës dhe Baletit dhe Filarmonisë së Kosovës, nën kujdesin e Ministrisë së Kulturës.

MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT TAKOHET ME BIZNESET PËR TË NGRITUR URA BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË

Për të promovuar **TUMO-n** dhe **Programin e Kodimit për të rinjtë**, ku bashkëpunimi me bizneset është thelbësor për të arritur rezultate edhe më të mira, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe drejtuesen e TUMO-s ka zhvilluar një **takim produktiv me bizneset e Dhomës Franceze Tregtare, përfaqësuesit dhe drejtuesit e kompanive të sigurimit, sektorit bankar, sektorit telekomunikacionit e shumë të tjerë.**

Bizneset shprehën gatishmërinë për t'iu bashkuar këtij projekti madhor, për të ardhmen e të rinjve shqiptarë në **fushën e teknologjisë së informacionit**, për të cilët së shpejti do të konkretizohen të gjithë këto bashkëpunime!



MBAHET MBLEDHJA E PËRBASHKËT MES DY QEVERIVE, SHQIPËRI DHE MAQEDONI E VERIUT.

Më 14 nëntor u mbajt **mbledhja e përbashkët mes dy qeverive, Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut**, për të rritur edhe më tej **ndërveprimin mes shteteve dhe zgjeruar bashkëpunimin**, nëpërmjet nënshkrimit të disa **marrëveshjeve ndërqeveritare.**

Gjatë kësaj mbledhjeje u theksua se **Procesi i "Ballkanit të Hapur"** dhe **Procesi i Berlinit** duhen parë si pjesë të njëra-tjetrës dhe si mundësi për të rritur edhe më tej bashkëpunimin në rajon.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi